



Deklarate e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u njoh me deklaratën e informacioneve dhe perfundimeve paraprake të Misionit Nderkombëtar të Vezhgimit të Zgjedhjeve mbi zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 12 Tetorit 2003, mision që përfshin OSBE/ODIHR dhe Keshillin e Europës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e vlerëson këto deklarata si realiste në pasqyrimin e fakteve të lidhura me procesin e përgatitjes së procesit zgjedhor në përgjithësi dhe ditës së zgjedhjeve në veçanti.

KQZ e konsideron të rëndësishëm deklarinë e sotëm të Misionit Nderkombëtar të Vezhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, së zgjedhjet e 12 Tetorit shënuan një progres të metejshëm në përputhje me standartet dhe angazhimet e OSBE-së, Keshillit të Europës dhe organizmave të tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike dhe mirëkupton faktin se mbeten për t'u trajtuar një sërë mangësish përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, veçanërisht në lidhje me listën e votuesve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson përfundimin e vëzhguesve ndërkombëtare se KQZ meriton vlerësim për administrimin e zgjedhjeve në një mënyrë përgjithësisht profesionale, transparente, madje edhe objektive.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mirëkupton përfundimin e Misionit të Vezhgimit të OSBE/ODIHR mbi mangësitë e listës së zgjedhësve, por dhe progresin që është bërë që nga procesi i kaluar zgjedhor në Shqipëri. KQZ do të konsiderojë me vemendje përfundimin e vëzhguesve ndërkombëtare se Komisioni nuk iu përmbajt afatëve të shpërndarjes së listave pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u përpoq të plotësonte kërkesat e partive politike duke i bërë një mosshërbim vetë zgjedhësve.

Më gjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr dijeni për qëndrimin e Misionit të Vezhgimit të Zgjedhjeve të OSBE / ODIHR, se mangësitë në listën e zgjedhësve nuk ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve dhe se nuk ka

asnje prove se ato jane te manipuluar, duke e renditur kete ceshtje ne detyrat paresore te KQZ ne pergatitjet e procesit te ardhshem zgjedhor.

Shqetesimit te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve i bashkohet me qendrimin e vezhguesve nderkombetare se puna e madhe e bere ne komisionet e qendrave te votimit, po demtohet nga bllokimi i punes ne komisionet zgjedhore te qeverisjes vendore. KQZ vlereson perfundimin e Misionit te Vezhgimit se problemet zgjidhen vetem ndermjet ankimimeve ligjore dhe jo permes bllokimit te zgjedhjeve.

Per sa i perket verejtjeve te Misionit te Vezhgimit te Zgjedhjeve te OSBE / ODIHR se anetaret e Komisioneve Zgjedhore te Qeverisjes Vendore dhe Komisioneve te Qendrave te Votimit, ne pergjithesi kane patur njohuri te pakta te Kodit Zgjedhor dhe te udhezimeve kryesore te KQZ-se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e vlereson kete si fakt realist, pavaresisht se jane organizuar 4 trajnime intensive per KZQV-te dhe nje trajnim per KQV-te. Por, vetem per sa i perket KZQV-ve, partite politike i kane kerkuar KQZ-se 923 zevendesime te anetareve te komisioneve vendore te mesiperme duke sjelle ne perberje te ketyre komisioneve persona pa trajnimin e duhur.

Ne perfundim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mirekupton perfundimet e deklarates se Misionit te Vezhgimit te Zgjedhjeve te OSBE / ODIHR dhe rikujton se KQZ mbetet e angazhuar per nxjerrjen sa me te shpejte te rezultateve perfundimtare te zgjedhjeve.

#